



Ministry of Foreign Affairs
and International Cooperation



04 prill 2023

THIRRJE PËR APLIKIME

Trajnime profesionale për zhvillimin e aftësive digjitale

Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), në bashkëpunim me Ministrinë e Pushtetit dhe Administratës Lokale dhe RIT Kosova (AUK), si dhe me mbështetjen financiare të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar të Republikës së Italisë, shpallin të hapur thirrjen për aplikime në kuadër të Iniciativës për Aftësi Digjitale (IAD).

RETH PROJEKTIT

Iniciativa për ofrimin e trajnimeve profesionale për zhvillimin e aftësive digjitale për të gjithë, është pjesë e Projektit të UNDP-së për Aftësitë Digjitale i cili ka për qëllim shfrytëzimin e potencialit të sektorit privat për të rritur aftësitë e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) tek të rinjtë në Kosovë. Projekti do të mbështesë deri në 180 gra dhe burra të rinj të moshës 18-29 vjeç, të cilët synojnë të zhvillojnë dhe përmirësojnë aftësitë digjitale, përmes kurseve praktike në kuadër të IAD.

Nisma do të mbështesë të rinjtë dhe të rejtat në zhvillimin e aftësive digjitale atraktive për tregun e punës, përmes trajnimeve intensive përmes gjashtë profileve kryesore: Aplikacionet celulare, Zhvillimi i Uebit, Inxhinieria e të Dhënave, Rrjeta, Marketingu Digjital, Dizajn Digjital. Trajnimet janë programe afatshkurtra intensive trajnimi që synojnë t'u ofrojnë pjesëmarrësve zhvillimin e aftësive digjitale që i përgatisin ata për tregun e punës dhe punësim të qëndrueshëm brenda sektorit privat.

Të rinjtë dhe të rejtat që aspirojnë të zgjerojnë ekspertizën e tyre digjitale, veçanërisht ata të komuniteteve pakicë, inkurajohen t'i paraqesin aplikimet e tyre **para datës 24 prill 2023**.

Pakot e kurseve intensive sipas profileve dhe moduleve					
Aplikacionet për celularë	Zhvillimi i faqeve të internetit	Inxhinieria e të dhënave	Rrjetëzimi	Marketingu digjital	Dizajni digjital
SWIFT NodeJS Reagoni	JavaScript HTML CSS	SQL Python NoSQL (MongoDB, Redis)	CCNA	SEO Marketingu i mediave sociale Photoshop	ADOBE XD Photoshop Animacioni në 3D Aplikacionet e modifikimit të videove

IAD REALIZOHET NËPËRMJET FAZAVE NË VIJIM

Faza e parë:

Pjesëmarrësit e interesuar duhet të aplikojnë me anë të formularit të mëposhtëm për aplikim: [APLIKO TANI](#)

Faza e dytë: IAD dhe RIT Kosova (AUK) do t'i ftojnë kandidatët për provim pranues dhe do t'i vlerësojnë të gjitha aplikimet e tyre duke u bazuar në njohuritë e përgjithshme që kanë të bëjnë me pakot e trajnimit. Lista e kandidatëve të përzgjedhur do të publikohet me pikët e arritura nga secili kandidat, ndërsa në të do të përcaktohet rangimi dhe vendosja e kandidatëve për kurset intensive për fillestarë.

Faza e tretë: Duke u bazuar në rezultatet e përzgjedhjes, secili kandidat i kualifikuar do të njoftohet për vendosjen e tij në kuadër të kurseve intensive për fillestarë dhe për orarin e trajnimit. Trajnimet do mbahen hibride 60% fizikisht , 40 % online. Gjuha bazë e trajnimeve do jetë gjuha angleze.

Shënim: Një listë e pritjes do të përpilohet duke u bazuar në rangimin e kandidatëve. Në rast të tërheqjes apo mospjesëmarrjes, kandidati do të zëvendësohet menjëherë me një kandidat të ri nga lista e pritjes.

Afati kohor për aktivitetet:



KUSH MUND TË APLIKOJË?

KANDIDATËT

Personat e kualifikuar që mund të aplikojnë për IAD duhet t'i plotësojnë kushtet në vijim:

- Të jenë të gjithë të rinjë nën moshën 29 vjeç
- Të jenë studentë dhe të sapodiplomuar në nivelin e studimeve të rregullta (Baçelor)

Grupet prioritare

- Të sapodiplomuarit e rinj (grupet e të diplomuarve në Baçelor brenda periudhës 2017 - 2023)
- Grupet e komuniteteve jo-shumicë
- Të rinjtë (18 - 24 vjeç)
- Gratë
- Persona nga zonat rurale
- Personat me aftësi të kufizuara

Personat që nuk kanë të drejtë për aplikim janë ata që:

- Nuk i përket grupmoshës 18-29 vjeç
- Kanë përfituar më parë nga Programi i Aftësive Digjitale.
- Janë në konflikt interesi me akterët e Programit dhe vendimmarrësit.

Thirrja për aplikim do të mbetet e hapur deri më 24 prill 2023

MBËSHTETJA FINANCIARE

Shpenzimet e kurseve IAD do t'i mbulojë Programi.

Lidhur me Projektin e UNDP-së për Iniciativa për Aftësitë Digjitale në Kosovë

Projekti bazohet në potencialin e ekonomisë digjitale për të ofruar mundësi punësimi dhe për t'i kontribuar rritjes ekonomike për përmirësimin e jetesës së të rinjëve. Në veçanti, kjo ndërhyrje ofron mundësi për zhvillim të aftësive, si mundësi tejet e rëndësishme për t'i shtuar mundësitë për punësim, si për zhvillim të qëndrueshëm, ashtu edhe për kohezion social, duke synuar grupe të veçanta të popullsisë. Projekti synon ta tejkalojë hendekun midis shkathtësive të grupit të synuar të popullsisë dhe nevojave të tregut të ekonomisë digjitale, si mjet për krijimin e vendeve të reja të punës dhe për rritje ekonomike, duke e avancuar, në të njëjtën kohë, dialogun dhe mirëkuptimin ndëretnik. Përmes një qasjeje për aftësi digjitale për të gjithë, projekti do ta rrisë tërësinë e aftësive digjitale përmes kurseve intensive për fillestarë në gjashtë fusha kryesore: dizajn digjital, marketing digjital, zhvillim të faqeve të internetit, rrjetëzim, aplikacione për celular dhe inxhinieri të të dhënave. Nëpërmjet IAD, projekti parasheh t'i aftësojë deri në 180 gra dhe burra, si dhe t'ua mundësojë grave të reja që të kenë qasje në mundësitë për punë të pavarur online. Gjatë trajnimeve do të ofrohen njohuri praktike themelore, ndërsa përdoruesit do të njihen me një varg veglash dhe gjuhësh të programimit për të cilat ka kërkesë të madhe brenda sektorit të TIK-ut aktualisht.

